

**VENDIM**  
**Nr. 61, datë 25.2.2021**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË  
“RREGULLOREN DHE METODOLOGJINË PËR LLOGARITJEN DHE  
VENDOSJEN E DËMIT EKONOMIK TË SHKAKTUAR NGA NDRËHYRJET E  
PALIGJSHME NË SISTEMIN E MATJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 77, pika 9, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 15, 19 dhe 26, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 25.2.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 30/6 prot., datë 18.2.2021, të përgatitur nga drejtoritë teknike, mbi fillimin e procedurës për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në “Rregulloren dhe metodologjinë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike”, konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 232, datë 20.12.2019, ka miratuar “Rregulloren dhe metodologjinë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike”.

- Shoqëria Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSSH sh.a.), me shkresën nr. 7997 prot., datë 21.10.2020, ka propozuar disa shtesa dhe ndryshime në “Rregulloren dhe metodologjinë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike”.

- Shoqëria OSSH sh.a. propozon të përfshihen në nenin 2 të rregullores, “Objekti” edhe rastet si më poshtë vijon:

- ndërhyrje në sistemin e matjes (makineri e hapur) në bokse kolektive;

- përdorues rrjeti me linjë të dytë në bokse kolektive;

- përdorues rrjeti me neuter të këputur në bokse kolektive;

- përdorues rrjeti me faza të shuntuara në bokse kolektive;

- përdorues të lidhur në rrjet pa kontratë.

- Shoqëria OSSH sh.a., propozon ndryshime në nenin 10, të rregullores, si më poshtë:

- Afati i lëshimit të faturës, në kushtet kur OSSH sh.a., punon me sistem faturim me cikël 30-ditor dhe printimi është i tillë, afati lidhur me lëshimin e faturës të jetë brenda 30 ditëve ose ciklit mujor të lexim/faturimit.

- Njoftimi i Furnizuesit të bëhet nga momenti i emetimit të faturës përkatëse, si momenti që zyrtarizon shkeljen.

- Shoqëria OSSH sh.a. duhet të bashkëngjisë edhe draftin e rregullores me formulimet e shtesave të propozuara dhe ndryshimeve përkatëse të neneve të cilat afektohen nga këto shtesa dhe ndryshime, si dhe të paraqesë informacionin shtesë mbi sa propozuar, duke argumentuar sa më qartë nevojën për përfshirjen e këtyre tipologjive të ndërhyrjeve në rregullore, si dhe duke paraqitur llogaritjet e saj mbi kundërvlerën në lekë të dëmit ekonomik, i cili do t’u faturohet përdoruesve të rrjetit për shtesat dhe ndryshimet e propozuara.

- “Rregullorja dhe metodologjia për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 232, datë 20.12.2019, në nenin 13, përcakton se kjo rregullore është objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të Bordit të ERE-s.

- Ndryshimet e propozuara në nenin 2 të rregullores, nuk argumentohen nga OSSH sh.a. dhe nuk saktësojnë kategoritë e shkaktuesve të dëmit të cilët duhen përfshirë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e një ndryshimi në nenin 10, të “Rregullores dhe metodologjisë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike”, për afatet e lëshimit të faturës për Përdoruesin e Rrjetit dhe njoftimin e Furnizuesit.

2. Refuzimin e propozimit për ndryshim të nenit 2, të “Rregullores dhe metodologjisë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike”.

3. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Petrit Ahmeti**